
FIER

RAPORT MONITORIMI

FUSHA: MJEDIS



KONTRATA E KONCESIONIT / PPP

Për ndërtimin e administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë

VLERA E KONTRATËS

4,5 miliardë lekë

32,8 mil. EUR

AUTORITETI KONTRAKTOR

Ministria e Mjedisit

AFATI

6 vjet

Nëntor 2022

www.opc.al

Centre for Legal Empowerment
www.cle.al

ALBANIAN INSTITUTES for Research

Kingdom of the Netherlands

RAPORT MONITORIMI

Kontrata e koncesionit: “Për ndërtimin e administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë”

1. Hyrje

Ky raport mbështetet në **Metodologjinë për monitorimin financiar të kontratave të koncesioneve dhe PPP** dhe në kontratën e koncesionit të formës BOT (Build-Operate-Transfer/Ndërtim-Operim-Transferim): “Për ndërtimin e administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë”. Ky raport njëkohësisht shërben si model për zbatimin e strukturës së metodologjisë (pesë fushat e monitorimit, indikatorët bazë dhe formati PPP-ID) dhe si udhëzues për replikimin e metodologjisë për kontrata të tjera të ngjashme afatgjata të investimeve në infrastrukture koncesione apo PPP.

Analiza mbështetet kryesisht në dokumentacionin kontraktor të disponueshëm: kontrata bazë e koncesionit[1], njoftimi i kontratës së nënshkruar nga Agjencia e Prokurimit Publik[2], dy marrëveshjet shtesë për shtyrjen e afatit të ndërtimit (2019 dhe 2020)[3][4], si dhe pasqyrat financiare të shoqërisë koncesionare[5]. Për strukturën, vlerën e parasë dhe parametrat teknikë janë përdorur dokumentat standarde të tenderit, studimi i fizibilitetit me modelin financiar dhe specifikimet teknike të impiantit[6][7][8]. Për angazhimet dhe pagesat fiskale janë përdorur Raportet Vjetore të Përmbledhura (RVP) 2022–2024 dhe Deklaratat e Risqeve Fiskale (DRF) të Ministrisë së Financave[9]. Elemente të lidhura me konteksti hetimor dhe transparencën mbështeten në njoftimet zyrtare të SPAK dhe burime mediatike e investiguese, të referuara me burimet respektive në çdo rast.

Çfarë ofron dhe çfarë nuk zëvendëson ky raport

[1]Kontratë koncesioni Nr. 5553/5 prot., datë 24.10.2016, ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë “Integrated Technology Waste Treatment Fier” sh.p.k. Kontrata e siguruar nga https://www.opencorporates.al/sq/nuis/l62205045f

[2]Agjencia e Prokurimit Publik, Buletini nr. 45, datë 14 nëntor 2016, Formular i publikimit të njoftimit të kontratës.

[3]Marrëveshje (aneks) referuar Kontratës së Koncesionit, 2019, në bazë të Autorizimit nr. 5683/2, datë 29.10.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë; grafik i rishikuar i punimeve me shtyrje rreth 9-mujore.

[4]Marrëveshje për ndryshimin e kontratës dhe grafikut të punimeve, 2020, në bazë të Autorizimit nr. 5583/4, datë 31.08.2020. Shtyrje e përfundimit të punimeve deri më 31 mars 2021.

[5]Pasqyra financiare të shoqërisë (vitet 2016–2019), të depozituara pranë QKB.

[6]Dokumentat standarde të procedurës përzgjedhëse konkurruese, Ministria e Mjedisit. Bonusi prej 10% të pikëve për përgatitjen e studimit të fizibilitetit u miratua me VKM nr. 341, datë 04.05.2016, në bazë të Ligjit nr. 125/2013.

[7]Studimi i fizibilitetit, plan-biznesi dhe modeli financiar.

[8]Specifikimet teknike të impiantit (raport teknik, Aneks): kapacitet djegieje 7.5–8.3 t on/orë ose 180–200 ton mbetje urbane/ditë. Fuqi elektrike e prodhuar gati 3.85 MW.

[9]Ministria e Financave, Raporti Vjetor i Përmbledhur i Performancës së Kontratave Koncesionare/PPP (RVP) 2022, 2023 dhe 2024 (të dhëna identifikuese, pagesa plan/fakt dhe ndarja e riskut).

Raporti ofron një panoramë të strukturuar, faktike dhe të krahasueshme të strukturës së kontratës, angazhimeve financiare, mekanizmit të pagesës, riskut fiskal dhe transparencës. Ai nuk zëvendëson auditimin financiar, ekonomik apo ligjor, as analizat e detajuara të flukseve të parasë apo krahasuesin e sektorit publik (PSC). Gjetjet duhen lexuar si bazë për debat, monitorim dhe kërkim të mëtejshëm.

2. PPP-ID

Tabela e mëposhtme përmbledh të dhënat kryesore identifikuese, financiare, fiskale dhe operacionale të kontratës.



3. Fushat e monitorimit

Fusha I: Struktura e kontratës

Kontrata e koncesionit u nënshkrua më **24 tetor 2016** ndërmjet Ministrisë së Mjedisit si autoritet kontraktues dhe shoqërisë **"Integrated Technology Waste Treatment Fier" sh.p.k.** si koncesionar. Shoqëria u krijua në tetor 2016 nga bashkimi i operatorëve "Integrated Technology Service" sh.p.k. dhe Energy 2 s.r.l. Objekti është financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi dhe mirëmbajtja e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimi i energjisë elektrike.

Kontrata është **kontratë ndërtim-operim-transferim (BOT)**, me kohëzgjatje **6-vjeçare (72 muaj)** nga data efektive (raportuar nga Ministria e Financave si 30 nëntor 2016). Ky projekt ka një **fazë ndërtimi të konsiderueshme** ku pesha kryesore fillestare është kostoja kapitale e ngritjes së impiantit, ndërsa shteti angazhohet të kryejë pagesa mujore mbështetjeje financiare gjatë gjithë afatit.

Procedura konkurruese për këtë projekt u zhvillua me **vetëm një ofertë të rregullt**. Në njoftimin e Agjencisë së Prokurimit Publik projekti është i regjistruar si procedurë të hapur[10],

[10]Agjencia e Prokurimit Publik, Buletini nr. 45, datë 14 nëntor 2016, Formular i publikimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar.

ndërsa në raportimet e Ministrisë së Financave projekti klasifikohet si "propozim të pakërkuar"[11]. Shoqëria koncesionare u themelua rreth një muaj para nënshkrimit të kontratës ndërkohë që dokumentat standarde të tenderit konfirmojnë se projekti buron nga një propozim i pakërkuar. Shoqërisë që përgatiti studimin e fizibilitetit

"Building Construction & Green Energy" iu akordua një bonus prej 10% të pikëve, sipas VKM nr. 341, datë 04.05.2016.[12]

Pas nënshkrimit, kontrata ka pësuar të paktën **dy ndryshime formale** që lidhen me shtyrjen e afatit të ndërtimit. Fillimisht me marrëveshjen e vitit 2019 (në bazë të Autorizimit nr. 5683/2, datë 29.10.2019), ku projekti u shty me rreth 9-muaj[13], dhe marrëveshja e vitit 2020 (Autorizim nr. 5583/4, datë 31.08.2020), që e shtyu përfundimin e punimeve deri më 31 mars 2021[14]. Gjatë kësaj periudhe AKUM u përcaktua si autoritet zbatues dhe i autorizuar për nënshkrimin e dokumenteve lidhur me këtë kontratë sipas kërkesave të shoqërisë koncesionare.

Fusha II: Angazhimet financiare të shtetit

Vlera e investimit sipas kontratës është **3,763,851,097 lekë pa TVSH** (4,516,621,316.73 lekë me TVSH), ose afërsisht 27.36 milionë euro pa TVSH / 32.83 milionë euro me TVSH[15]. Kjo shumë konfirmohet edhe nga raportet vjetore të Ministrisë së Financave. Sipas kësaj kontrate, shteti angazhohet të kryejë **pagesa të drejtpërdrejta (mbështetje financiare)** për koncesionarin, në formën e 72 kësteve mujore sipas Aneksit V, brenda datës 10 të çdo muaji, duke filluar nga muaji i parë i datës efektive.

Sipas raportimit të Ministrisë së Financave, pagesat buxhetore faktike për këtë kontratë paraqiten si më poshtë (në mijë lekë):

Viti	Plan	Fakt	Koment
2018	752,772	752,771	Vit i parë i pagesave të mbështetjes financiare
2019	752,772	725,770	Nën nivelin e planifikuar
2020	755,500	752,770	Pranë nivelit të plotë
2021	752,771	690,040	Sipas RVP 2022 (RVP 2023 raporton 775,771)

[11]Ministria e Financave, Raporti Vjetor i Përmbledhur i Performancës së Kontratave Koncesionare/PPP (RVP) 2022, 2023 dhe 2024.

[12]Dokumentat standarde të procedurës përzgjedhëse konkurruese, Ministria e Mjedisit. Bonusi prej 10% të pikëve për përgatitjen e studimit të fizibilitetit u miratua me VKM nr. 341, datë 04.05.2016, në bazë të Ligjit nr. 125/2013.

[13]Marrëveshje e vitit 2019. Grafik i rishikuar i punimeve me shtyrje rreth 9-mujore.

[14]Marrëveshje për ndryshimin e grafikut të punimeve, e vitit 2020. Shtyrje e përfundimit të punimeve deri më 31 mars 2021.

[15]Neni 10.5 në kontratën e koncesionit.

Viti	Plan	Fakt	Koment
2022	376,400	376,385	Sipas RVP 2022 (RVP 2023 raporton 690,040)
2023	-	-	Asnjë pagesë nga buxheti (asetet nën sekuestro)
TOTALI	**3,390,215**	**3,297,736**	

Një tipar qendror i këtij projekti është se **pagesat e mbështetjes financiare nisën që në vitin 2018 ndërkohë që vijonte ndërtimi i impiantit dhe përpara afatit të përfundimit të tij** që shty deri më 31 mars 2021. Shuma e paguar 2018–2022 (rreth 3.3 miliardë lekë) që është gati 88% e vlerës së plotë të investimit (pa TVSH) sipas kontratës, pavarësisht ecurisë së ndërtimit dhe statusit të vënies në punë të impiantit.

Përveç pagesave të drejtpërdrejta nga buxheti, kontrata e projektit parashikon edhe një **tarifë koncesioni prej 3% të të ardhurave vjetore** nga aktiviteti ekonomik, që koncesionari i detyrohet autoritetit kontraktues. Raportet publike të monitorimit të kontratave të koncesioneve/PPP nuk përmbajnë informacion lidhur me pagesat e tarifës koncesionare nga kompania.

Modeli financiar i paraqitur në studimin e fizibilitetit mbështetet kryesisht në dy burime kryesore të ardhurash si pagesat e drejtpërdrejta nga buxheti i shtetit dhe të ardhura nga shitja e energjisë elektrike. Në studim parashikohet një investim prej rreth 27.36 milionë euro[16] dhe një çmim i mesatarizuar prej **8.4 lekë/kWh** për shitjen e energjisë tek KESH Sh.A. Sipas vetë modelit, periudha e kthimit të investimit rezulton **rreth 16 vjet**, me një normë të brendshme kthimi (IRR) afërsisht 5.3%. Kjo normë kthimi është shumë më e gjatë se afati 6-vjeçar i koncesionit. Ky tregues i kthimit tregon se të ardhurat nga energjia nuk e mbulojnë investimin brenda afatit të koncesionit duke e bërë mbështetjen e drejtpërdrejtë buxhetore përcaktuese për qëndrueshmërinë financiare të projektit.[17]

Fusha III: Mekanizmat e pagesës

Mekanizmi kryesor i pagesës së projektit është nëpërmjet **pagesave mujore të drejtpërdrejta nga buxheti i shtetit si** (mbështetje financiare), të shpërndara në 72 këste. Ndryshe nga inceneratori i Tiranës, ku raportimi fiskal e përshkruan financimin si “pay per use” (tarifë fikse për ton mbetjesh të depozituara nga njësitë vendore), për Fierin burimi mbizotërues është pagesa e drejtpërdrejtë buxhetore e parashikuar në kontratë.

Megjithatë, kontrata përmban një **garanci sasie minimale mbetjesh nga shteti** ku autoriteti kontraktues është përgjegjës të sigurojë një sasi mesatare minimale ditore prej

[16] (kurs 1 EUR = 137.57 lekë, Shtator 2016

[17] Sipas modelit financiar në studimin e fizibilitetit të projektit.

160 ton mbetje/ditë, dhe në rast mosplotësimi detyrohet të paguajë vlerën e mbetjeve të munguara mbi bazën e çmimit për kWh të miratuar nga ERE. Ky kriter në kontratën e koncesionit do të thotë se një pjesë e konsiderueshme e riskut të kërkesës (vëllimi i mbetjeve) mbartet *de facto* nga shteti.

Kontrata e koncesionit, për fazën e ndërtimit të impianti, parashikon **penalitete për vonesa** (nga 400 deri 2,250 euro/ditë sipas gjatësisë së vonesës) dhe një sigurim kontrate prej 10% të vlerës totale, që zëvendësohet me një sigurim prej 1% të vlerës së investimit për fazën operacionale. Lidhur me ecurinë e fondeve të sigurimit të kontratës si në fazën e ndërtimit ashtu edhe gjatë fa nuk ka informacion të përcjellë nga institucionet apo të disponueshëm publikisht.

Fusha IV: Risku fiskal

Sipas raportimit të Ministrisë së Financave, koncesionarit i janë alokuar risku financiar, risku i vendodhjes, risku i operimit dhe i transferimit të aseteve, ndërsa autoriteti kontraktues mban riskun e qeverisjes, riskun politik dhe riskun e ndryshimeve ligjore. Sipas informacionit nga Ministria e Financave, në raportin për vitin 2022 raportohet që, risku i lejeve dhe licensave, risku i forcës madhore, risku i rinegocimit dhe risku i ndërprerjes së kontratës janë ndarë mes të dyja palëve. Ndërkohë që në raportin e 2023 përfshihet edhe **risku i kërkesës dhe risku i ndërtimit si të ndarë mes të dyja palëve**.[18] Ndarja "de facto" e riskut të ndërtimit dhe të kërkesës është e dukshme nga garancia e sasisë minimale të mbetjeve dhe pagesat e drejtpërdrejta para vënies në punë të cilat e zhvendosin një pjesë të ekspozimit tek buxheti i shtetit.

> Risku i ndërtimit u materializua duke shkaktuar shtyrjen të paktën dy herë (rreth 9 muaj në 2019 dhe edhe 8 muaj në 2020, deri më 31 mars 2021). Megjithëse nga institucionet nuk janë përcjellë të dhëna operative të projektit sipas raportimeve mediatike impianti nuk rezultonte funksional edhe pas skadimit të afateve. Rrjedhimisht vonesa në një kontratë BOT rrezikon drejtpërdrejt vlerën e parasë publike kur pagesat nisin para se shërbimi të jetë i disponueshëm.

Në vijim Shoqëria koncesionare ka shfaqur **vështirësi financiare të theksuara** kjo e reflektuar edhe nga pasqyrat financiare të raportuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Kompania regjistron një kapital aksionar simbolik prej 100,000 lekë dhe ndërtimin të aktiveve afatgjata prej rreth 2.1 miliardë lekë deri në vitin 2019 të financuar kryesisht nga detyrime ndaj klientëve dhe hua[19]. Gjithashtu ndaj shoqërisë janë vendosur dhe disa **masa**

[18]Ministria e Financave, Raporti Vjetor i Përmbledhur i Performancës së Kontratave Koncesionare/PPP (RVP) 2022, 2023 dhe 2024 (të dhëna identifikuese, pagesa plan/fakt dhe ndarja e riskut).
[19]Pasqyra financiare të shoqërisë "Integrated Technology Waste Treatment Fier" sh.p.k. (vitet 2016–2019), të depozituara pranë QKB.

sekuestroje konservative nga nënkontraktorë/kreditorë të ndryshëm për detyrime të papaguara.

Më 28 mars 2022, me vendimin nr. 134 të GJKKO, asetet e shoqërisë u vendosën nën **masë sigurimi pasuror "sekuestro preventive"** dhe administrohen nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.[20] Gjithashtu, kjo kontratë figuron në raportimin fiskal të Ministrisë së Financave (RVP/DRF) si PPP me mbështetje buxhetore, që tregon se ky projekt trajtohet si burim risku fiskal dhe angazhimi buxhetor.

Fusha V: Transparenca dhe vlera e parasë publike

Sigurimi i informacionit zyrtar lidhur me këtë kontratë është i vështirë dhe shumë informacione nuk janë lehtësisht të disponueshme për publikun nga faqet zyrtare të institucioneve. Konkretisht pas kërkesës zyrtare për informacion të paraqitur pranë institucioneve përgjegjëse sipas Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit":

- **Ministria e Mjedisit** nuk e vuri në dispozicion të dokumentacionit, duke u shprehur se ai është objekt hetimi dhe i është përcjellë SPAK-ut;
- **KLSH konfirmoi** se nuk ka kryer auditim për këtë kontratë;
- **Agjencia e Prokurimit Publik** sqaroi se nuk ka kompetencë monitorimi mbi kontratat koncesionare;
- **ATRAKO** në përgjigjen e tyre theksun rolin mbështetës dhe që kontrata dhe Aneksi IX disponohen prej saj, por regjistri elektronik rezultoi i paaksesueshëm;[21]
- **Ministria e Financave** drejtoi te Raporti Vjetor i Përmbledhur, publik.[22]

Për këto arsye, një kopje e skanuar e kontratës, anekset dhe të dhënat e pronësisë u siguruan përmes bazave të të dhënave të hapura të palëve të treta (OpenCorporates, Databaza e koncesioneve e BIRN Albania) dhe regjistrit të QKB-së.[23]

Dokumentat e tenderit përfshijnë një studim fizibiliteti me analizë financiare të "vlerës së parasë" që është përgatitur nga vetë shoqëria propozuese. Sidoqoftë kjo nuk zëvendëson një krahasues të pavarur të sektorit publik (PSC). Nga pikëpamja e tenderit të këtij projekti, procedura u zhvillua me një ofertë të vetme, nga një shoqëri të themeluar rreth një muaj para nënshkrimit.[24][25]

Projekti është objekt i një hetimi të gjerë të SPAK ku në procedurën e dhënies dhe lidhjes së kontratës janë konstatuar veprime në kundërshtim me ligjin për koncesionet dhe PPP-të dhe

[20] RVP 2024.

[21] Aksesuar në datën 28 Qershor 2026 në faqen zyrëtar të ATRAKO - https://atrako.gov.al/

[22] Korrespondenca e kërkesave për informacion (Ligji nr. 119/2014) e Centre for Legal Empowerment me Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Financave, Agjencinë e Prokurimit Publik, KLSH dhe ATRAKO (Shkurt–Qershor 2026), si dhe ankimi pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit lidhur me refuzimin nga Ministria e Mjedisit (Prill 2026).

[23] Kontrata dhe të dhënat e pronësisë u siguruan nga OpenCorporates Albania (NUIS L62205045F): https://www.opencorporates.al/sq/nuis/l62205045f si dhe nga Databaza e koncesioneve/PPP e BIRN Albania: http://ppp.reporter.al/al/ppp/Ndertimi-dhe-administrimi-i-impiantit-te-trajtimit-te-mbetjeve-urbane-ne-Fier-dhe-prodhimi-i-energjise.

[24] Studimi i fizibilitetit / plan-biznesi dhe modeli financiar (Aneksi III).

[25] Agjencia e Prokurimit Publik, Buletini nr. 45, datë 14 nëntor 2016.

atë për prokurimin publik.Gjithashtu SPAK ka ngritur edhe dyshime të tjera të lidhura me këtë projekt si ato për falsifikim dokumentacioni në procedurat e shpronësimit si dhe për një skemë faturimi fiktiv.[26]

4. Indikatorët bazë financiarë dhe fiskalë

Indikatorët janë llogaritur me të dhënat e disponueshme zyrtare.

Indikatori	Vlera për projektin e inceneratorin e Fierit	Interpretimi / pragu
Vlera e projektit në raport me Produktin e Brendshëm Bruto (PBB)	**4.5 miliardë Lekë / 1,501 miliard lekë (0.3%)**	Ky është një indikator informues lidhur me peshën relative që vlera e projektit zë në PBB-në e vitit të nënshkrimit.[27]
Pagesa totale 2018–2022	**3.3 miliardë lekë**	Në total nën 1% të GDP në periudhën e nënshkrimit.
Vlera e projektit në raport me totalin e investimeve publike	**4.5 miliardë / 57.8 miliardë lekë (7.81%)**	Ky është një tregues informues lidhur me peshën relative që vlera e projektit ka në raport me totalin e investimeve në vitin e nënshkrimit.
Vlera e investimit	**4.5 miliardë lekë me TVSH**	Peshë e konsiderueshme në sektorin e mjedisit
Pagesë vjetore / portofol PPP ndaj të ardhurave tatimore	**≈ 752 milion lekë/vit (0.27%)**	Nën tavanin ligjor 5% të të ardhurave tatimore
Devijim afati (ndërtim)	**Të paktën 2 shtyrje**	Më shumë se 6-muaj
Pagesa realizuar / planifikuar	**92–100% (2018–2022)**	Brenda normës deri 2022. Ndërprerje pas sekuestros
Garanci sasie (kërkesë)	**160 ton/ditë e garantuar nga shteti**	Risk kërkese i ndarë de facto me shtetin
Periudhë kthimi (payback) sipas modelit	**≈ 16 vjet (IRR ≈ 5.3%)**	Shumë më e gjatë se afati 6-vjeçar i projektit. Projekti ka varësi nga mbështetja buxhetore

[26] Këto të dhëna paraqiten këtu si kontekts lidhur me transparencën dhe verifikueshmërinë e projektit. Ky raport nuk merr qëndrim mbi përfundimet e proceseve gjyqësore në vijim dhe nuk paragjykon fajësinë e asnjë personi.
[27] Të dhënat mbi PBB-në dhe Investimet publike janë marrë nga tabelat e tregueseve fiskalë të konsoliduar në materialet e Buxhetit Vjetor nga Ministria e Financave. https://financa.gov.al/buxheti-ne-vite/

Indikatori	Vlera për projektin e inceneratorin e Fierit	Interpretimi / pragu
Indeksi i transparencës (vlerësim autori 0–5)	**2 / 5**	Akses zyrtar i kufizuar dhe i paaksesueshëm. Kontratë jo publike zyrtarisht, pa analiza VfM apo të krahasuesit publik të disponueshme

Tavani fiskal ligjor: pagesat vjetore neto nga kontratat koncesionare/PPP, si rregull, nuk duhet të tejkalojnë 5% të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës.[28]

5. Elementë sinjalizues (Red Flags)

Sinjal alarmi	Prezent?	Vërejtje
Kontratë e papublikuar / mangësi aksesi	Po	Kontrata në gjendet lehtësisht në burime publike.
Devijim afati mbi 6 muaj	Po	Dy shtyrje të afatit të ndërtimit (2019, 2020)
Pagesa para vënies në punë	Po	Mbështetja financiare nisi 2018 ndërkohë që impianti i papërfunduar
Garanci sasie (Risku i kërkesës)	Po	160 ton/ditë e garantuar. Risk kërkese i ndarë me shtetin.
Studim për vlerën e paras (VfM)	Po	Studimi u hartua nga vetë shoqëria. Nuk ka studim të publikuar nga autoriteti kontraktor.
Hetim/sekuestro penale	Po	Sekuestro preventive nga GJKKO (2022)
Mungesë auditimi të pavarur (KLSH)	Po	KLSH konfirmoi se nuk ka kryer auditim për kontratën
Akses i refuzuar në informacion	Po	Ministria e Mjedisit nuk përcolli informacionin e kërkuar duke e konsideruar si “objekt hetimi”.
Mungesë raportimi institucional	Jo	Raportohet rregullisht në RVP/DRF të MF

6. Gjetjet kryesore dhe kufizimet

[28]Tavani fiskal sipas nenit 4/2 të Ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 (shtuar me ligjin nr. 57/2016): pagesat vjetore neto nga kontratat koncesionare/PPP, si rregull, nuk duhet të tejkalojnë 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës.

Gjetjet kryesore

- Kontratë **BOT 6-vjeçare** për ndërtimin dhe operimin e një impianti trajtimi mbetjesh me prodhim energjie, me vlerë investimi rreth 4.5 miliardë lekë me TVSH dhe me pagesa të drejtpërdrejta mujore nga buxheti i shtetit.
- Procedura u zhvillua me **një ofertë të vetme**. Shoqëria koncesionare u themelua rreth një muaj para nënshkrimit të kontratës së koncesionit duke sinjalizuar kufizim të konkurrencës.
- Pagesat buxhetore faktike 2018–2022 arrijnë në **3.3 miliardë lekë**, **gati 88%** e vlerë së investimit, ndërkohë që ndërtimi u shty disa herë dhe statusi i vënies në punë mbetet i paqartë.
- Risku i ndërtimit u **materializua** përmes dy shtyrjeve të afatit. Ndërkohë që risku i kërkesës u nda *de facto* me shtetin përmes garancisë së sasisë minimale (160 ton/ditë).
- Koncesionari gjatë periudhës së ndërtimit dhe operimit më pas ka shfaqur vështirësi financiare (sekuestro nga kreditorë në 2020 dhe 2023) megjithëse pagesat nga autoriteti publik kanë qenë të rregullta për të gjithë periudhën. Tashmë asetet janë vendosur nën **sekuestro preventive nga GJKKO (2022)** në kuadër të hetimit të SPAK.
- Modeli financiar i vetë projektit parashikon kthim të investimit në **rreth 16 vjet (IRR = 5.3%)**, shumë më gjatë se afati 6-vjeçar. Në këtë rast, të ardhurat nga shitja e energjisë nuk e mbulojnë investimin brenda afatit të koncesionit, duke e bërë mbështetjen buxhetore përcaktuese.
- Transparenca lidhur me këtë projekt është **e dobët**. Nuk ka aksesi zyrtar në dokumente dhe pjesa më e madhe e informacionit mund të sigurohet nga burime jo-zyrtare.

Kufizimet e analizës

- Analiza mbështetet në informacionin e disponueshëm dhe lidhur me këtë projekt nuk ka raporte të ecurisë së punimeve apo të projektit në tërësi çka kufizon vlerësimin e performancës operacionale dhe të vlerës së parasë.
- Statusi i vënies në punë të impiantit nuk është konfirmuar me dokument zyrtar. Megjithëse sipas burime mediatike nuk është realizuar vendosja në punë e impiantit të përpunimit të mbetjeve dhe prodhimit të energjisë sipas përcaktimeve kontraktuale për këtë projekt koncesioni/PPP.
- Në përgjithësi aksesi zyrtar përmes kërkesave për informacion është i dobët dhe nuk ka burime të konfirmuara zyrtare ku të gjendet i gjithë informacioni i plotë lidhur me këtë projekt. Pra grupi i anekseve mund të jetë jo i plotë.

- Çështjet hetimore lidhur me këtë projekt janë në proces. Në këtë raport i jemi referuar këtij hetimi për të dhënë një kontekst të gjerë lidhur me projektin por ky raport **nuk merr qëndrim** mbi përfundimet e këtyre proceseve.

Interpretimi i rezultateve

Gjetjet e këtij raporti nuk janë konkluzione përfundimtare mbi performancën financiare apo ligjore të kontratës. Çdo gjetje referon burimin përkatës dhe shoqërohet me dokumentacionin mbështetës, në përputhje me parimet e neutralitetit analitik, krahasueshmërisë dhe replikueshmërisë.

Burimet kryesore

- Kontrata e koncesionit e formës BOT nr. 5553/5 prot., datë 24.10.2016 e lidhur midis Ministrisë së Mjedisit dhe kompanisë private "Integrated Technology Waste Treatment Fier" sh.p.k.
- Agjencia e Prokurimit Publik, Buletini nr. 45, datë 14.11.201mbi njoftimin e kontratës së nënshkruar.
- Marrëveshje për shtyrjen e afatit të ndërtimit (2019), Autorizim nr. 5683/2, datë 29.10.2019; Marrëveshje për ndryshimin e grafikut të punimeve (2020), Autorizim nr. 5583/4, datë 31.08.2020.
- Dokumentat standarde të procedurës përzgjedhëse konkurruese. VKM nr. 341, datë 04.05.2016 mbi bonusin 10% të dhënë për hartuesin e studimit të fizibilitetit.
- Studimi i fizibilitetit / plan-biznesi dhe modeli financiar (Aneksi III) si dhe specifikimet teknike të impiantit (raport teknik).
- Pasqyrat financiare të shoqërisë "Integrated Technology Waste Treatment Fier" sh.p.k. (2016–2019), QKB.
- Urdhra për vënien e sekuestros konservative ndaj shoqërisë koncesionare (2020 dhe 2023).
- Ministria e Financave – Raporti Vjetor i Përmbledhur i Performancës së Kontratave Koncesionare/PPP (RVP) 2022, 2023, 2024. Deklarata e Risqeve Fiskale (DRF) 2023, 2024.
- Burime të hapura për kontratën dhe pronësinë nga OpenCorporates Albania (NUIS L62205045F) si dhe Databaza e koncesioneve/PPP e BIRN Albania.
- SPAK – Njoftim për shtyp, 20.12.2022.
- Ligj nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar.

- Burime mediatike e investiguese të referuara në raport mbi pronësinë, kapacitetin, statusin e impiantit dhe hetimet penale.

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Strengthening capacities for the sustainable monitoring of public contracts", pjesë e programit Matra 2024. Përmbajtja e këtij dokumenti reflekton pikëpamjet e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimin apo politikat zyrtare të Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri. Ambasada nuk mban përgjegjësi për përdorimin e informacionit të përfshirë në këtë raport.